




## **Kosova dhe Ndryshimet Klimatike**



**Qasje strategjike ndaj konferencës së Kopenhagës mbi ndryshimet klimatike 2009**



**COP15  
COPENHAGEN**  
UN CLIMATE CHANGE CONFERENCE 2009

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

---

<b>Shkurtesat</b> .....	5
<b>Përmbledhje</b> .....	6
<b>KAPITULLI I NDRYSHIMET KLIMATIKE</b> .....	9
1.1 Çka është ndryshimi klimatik dhe pse është i rëndësishëm? .....	9
1.2 Efekti serrë .....	9
1.3 Pse janë ngritur emetimet e ges-it? .....	9
Angazhimi ndërkombëtar për ndryshimet klimatike .....	10
1.5 Protokolli i Kiotos.....	11
1.5.1 Protokolli i Kiotos: mekanizmat për uljen e emetimeve të GAZRAVE me efekt serë .....	12
1.5.2 Protokolli i Kiotos: sukses apo dështim? .....	13
1.6 Pas Kiotos .....	13
<b>KAPITULLI II NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE KOSOVA</b> .....	16
2.1 Kosova sot.....	16
2.2 Ndjeshmëria e Kosovës.....	16
2.2.1 Ndryshimet klimatike .....	17
2.2.2 Zhvillimi i paqëndrueshëm.....	17
2.2.3 Rreziqet shëndetësore.....	17
2.3 Kontributi i Kosovës në ndryshimet klimatike.....	17
2.3.1 Prodhimi i energjisë elektrike.....	17
2.3.2 Automjetet.....	18
2.3.3 Shpyllëzimi .....	18
2.4 Obligimet kushtetuese .....	19
2.5 Ballafaqimi me ndryshimet klimatike .....	19
2.5.1 Korniza ligjore .....	20
2.5.2 Zhvillimet e fundit.....	22
<b>KAPITULLI III NJË QASJE STRATEGJIKE PËR KOSOVËN</b> .....	24
3.3 Burimet alternative të energjisë.....	25

3.4	Reduktimi i gazrave dhe CO2 nga automjetet motorike:.....	25
3.5	Luftimi i shpyllëzimit .....	25
3.6	Adaptimi.....	25
3.7	Adresimi i vështirësive institucionale .....	26
3.8	Përgjigjja drejt BE-së dhe UNFCC-së: .....	26
	Burimet: .....	28
	Bibliografia: .....	29
	Shtojca 1 Efekti serrë.....	32
	Shtojca 2 Momentet historike te ndryshimeve klimatike .....	33
	Shtojca 3 Politikat rajonale .....	36

## FALËNDERIME

---

Autor: **Nils Pfeiffer**

Ndihmës hulumtuese: **Kaltrina Hoxha**

Redaktor: **Tom Fuller**

Përkthyes: **Kosova Language Solutions**

Lektor: **Blertha Halili**

Publikuar nga:



Balkan Investigative Reporting Network  
Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese

Mbështetur nga:



## SHKURTESAT

---

<b>MPZH</b>	Mekanizimi i Pastër për Zhvillim
<b>CO<sub>2</sub></b>	Dioksidi i karbonit
<b>KP</b>	Konferenca e Palëve
<b>MTE</b>	Mekanizmi për Tregtimin e Emetimeve
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>GES</b>	Gazrat me efekt serë
<b>IPCC</b>	Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike
<b>ZP</b>	Zbatimi i Përbashkët
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
<b>MAPH</b>	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>NATO</b>	Organizata Veri-Atlantike
<b>KB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>UNFCCC</b> Klimatike	Korniza e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike
<b>UNMIK</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
<b>SHBA</b>	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
<b>WHO</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë

## PËRMBLEDHJE

---

Këtë dhjetor, përfaqësuesit e rreth 192 shteteve u mblodhën në Kopenhage të Danimarkës në Konferencën e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike (UNFCCC) me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje mbi protokollin i cili do të përcaktonte atë se si bashkërisht do të mund të luftonin ndryshimet klimatike. Kjo do ta zëvendësonte Protokollin e Kiotos, i cili skadon në vitin 2012 dhe do të korrigjonte mangësitë.

Ky raport vë në dukje pozitën e Kosovës kundrejt ndryshimeve klimatike dhe përcakton një strategji të mundshme me reference ndaj kornizës UNFCCC dhe Kopenhagës.

Momentalisht, ndryshimet klimatike në Kosovë, nuk shihen si prioritet madhor as nga qeveria e as nga populli. Fokusimi është shprehur në zhvillimin ekonomik dhe në zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës si një shtet i pavarur. Megjithatë, ndryshimet klimatike, si rezultat i sasive të mëdha të dyoksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>) dhe gazrave të tjerë me efekt serë (GES) të cilat lirohen në atmosferë, kërkojnë vëmendjen edhe të Kosovës.

Evropa juglindore dhe Ballkani parashikohet që të vuajnë pasojat me shumë se pjesët e tjera të Evropës. Pa një veprim të vendosur, përpjekjet e Kosovës për zhvillimin e saj, do të minohen nga ndikimi i ndryshimeve klimatike në motin, ekologjinë, furnizimin me ujë, bujqësinë dhe ekonominë e saj. Kosova po ashtu duhet ta dëshmojë angazhimin e saj ndaj ndryshimeve klimatike:

- **Linjiti:** Linjiti është burimi kryesor i Kosovës dhe me gjasë udhëheqës i rritjes së saj ekonomike. Megjithatë, përdorimi i tij në prodhimin e energjisë elektrike nga dy termocentralë ekzistues, çdo vit do të çlironte diku përafërsisht 5.8 milion tonelata të CO<sub>2</sub> në atmosferë. Me ndërtimin e termocentralit të ri të planifikuar, Kosova do të ishte përgjegjëse për emetimin vjetor të CO<sub>2</sub> deri në 22.5 milion tonelata.
- **Automjetet:** Si pasojë e një teknologjie të vjetërsuar për reduktimin e emetimit përafërsisht në Kosovë emetohen 5.5 milion tonelata të CO<sub>2</sub> nga automjetet motorike.
- **Shpyllëzimi:** Prerja jo e rregullt e pyjeve të Kosovës po redukton kontributin pozitiv të këtij shteti në luftimin e ndryshimeve klimatike duke absorbuar CO<sub>2</sub>.

Disa mund të thonë se Kosova tani për tani nuk është e detyruar të veprojë në luftimin e ndryshimeve klimatike, meqë nuk është as palë nënshkruese e Protokollit të Kiotos e as anëtare e konventës UNFCCC. Megjithatë, qeveria e Kosovës ka për obligim moral dhe kushtetues që ta luftojë këtë problem. Po ashtu, duke vepruar tani, Kosova mund të demonstrojë botës seriozitetin e saj si një shtet i pavarur i cili është i gatshëm të punojë sëbashku me të tjerët. Kjo vetëm sa do ta avanconte çështjen e saj drejt njohjes së plotë nga ana e KB-ve dhe shteteve anëtare të BE-së.

Në krahasim me shtetet fqinje si Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia, Kosova është më së paku e përgatitur të merret me ndryshimet klimatike. Kjo reflektohet nga mungesa e kapacitetit të saj institucional, njerëzor dhe financiar për t'i dhënë përgjigje efektive këtij problemi. Po ashtu, nuk ka demonstruar vendosmëri në vullnetin politik, gjë, të cilën e kanë treguar të tjerët në punën e tyre për të arritur përputhshmëri me BE-në, anëtare të të cilit të gjithë aspirojnë të bëhen.

Konferenca mbi ndryshimet klimatike e zhvilluar në Kopenhagë për Kosovën paraqet një sfidë e po ashtu edhe një mundësi. Meqë Kosova, e cila nuk është e anëtarësuar në KB e po ashtu nuk është pjesë e anëtarëve të konventës së UNFCCC, do të duhej të përgatitet për t'u përballur me ndryshimet klimatike. Ideale do të ishte formulimi i një strategjie mbi ndryshimet klimatike e cila do të ishte në përputhshmëri me objektivat e UNFCCC.

Një strategji e tillë për 20 vitet e ardhshme do të përfshinte synimet si në vijim:

#### Sektori i Energjisë

- Reduktimi i emetimeve të CO<sub>2</sub> dhe GES kryesisht nga termocentralet e energjisë elektrike me linjit (si ato ekzistuese ashtu edhe ato të planifikuara), po ashtu edhe nga gjeneratorët dhe drurit të zjarrit
- Zbatimi teknologjive të pasteta me thëngjill
- Përdorimi i teknologjive për zënien dhe ruajtjen e karbonit në termocentralet e reja
- Zhvillimi i burimeve alternative dhe të ripërtërishme të energjisë (siç është energjia e erës ose ajo solare ) si dhe zvogëlimi i tatimit më qëllim të inkurajimit të sektorit privat që ta bëjë të njëjtën gjë
- Rritja e efikasitetit të energjisë
- Futja në fuqi dhe zbatimi i legjislacionit, si atij ekzistues dhe atij në të ardhmen

#### Transporti

- Zhvillimi i pajisjeve për monitorimin e emetimeve të CO<sub>2</sub>
- Krijimi i një regjimi tatimor në atë mënyrë që të inkurajohen qytetaret të ngasin vetura që ndotin me pak
- Futja në fuqi në mënyrë efektive dhe zbatimit të legjislacionit

#### Shpyllëzimi

- Ngritja e vetëdijes politike dhe të popullatës mbi rëndësinë e pyjeve të Kosovës
- Të sigurohet një menaxhim efektiv i mbrojtjes së pyjeve si dhe zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e pyjeve

- Zhvillimi i programeve të rimbjelljes së fidanëve dhe planeve për reduktimin e përdorimit të drurit për ngrohje dhe gatim

#### BE 2020

- Veprimi në përputhje me objektivat e BE-së, përkatësisht uljet prej 20% të emetimeve të GES-it , konsumit të energjisë dhe ngritja prej 20% e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2020

#### UNFCCC

- Përputhja me zotimet e UNFCCC njësoj sikur Kosova të ishte palë e organizatës
- Zhvillimi i programeve shtetërore dhe rajonale për zbutje dhe përshtatje.
- Përzgjedhja e një viti bazë nga i cili do të mateshin emetimet e GES-it
- Përgatitja e një raporti “për komunikim shtetëror” për UNFCCC rreth situatës, sfidave mundësive dhe progresit të Kosovës lidhur me ndryshimet klimatike
- Integrimi i politikave të ndryshimeve klimatike në planet zhvillimore të qëndrueshme të shtetit
- Promovimin dhe bashkëpunimin në bartjen e teknologjive miqësore për mjedisin
- Promovimi i hulumtimeve përkatëse, shkëmbimit të informacioneve, edukimit dhe ngritjes së kapaciteteve
- Krijimi i një inventarizimi shtetëror të GES-it
- Prodhimi i skenarëve të ndryshimeve klimatike për sektorët socialë, ekonomikë dhe mjedisor

Të gjitha këto veprimtari mund të arrihen nëse fillohen tani dhe kryhen brenda afateve kohore që pasqyrojnë kapacitetet institucionale dhe financiare të Kosovës. Gadishmëria politike, është faktori më i rëndësishëm në mundësinë e arritjes së tyre. Konferenca e Kopenhagës i paraqet Kosovës një pikë fillimi ideale.

## KAPITULLI 1 NDRYSHIMET KLIMATIKE

---

### 1.1 ÇKA ËSHTË NDRYSHIMI KLIMATIK DHE PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Ndryshimi klimatik me sa duket është kërcënimi më i madh ekonomik, social, mjedisor dhe politik për të ardhmen e njerëzimit. Si rezultat i temperaturave në ngritje, jemi dëshmitarë të niveleve të ngritura të detit, akullnajave që po shkrihen, ngricave të përhershme dhe akullit në detin Arktik; temperaturave në ngritje të detrave; vërshimeve të shkaktuara nga reshjet e mëdha; thatësirave të skajshme dhe ekosistemeve ndryshuese. Gjithashtu, ka mundësi që ndryshimi klimatik ka rritur rastet e sëmundjeve që ndërliken me nxehtësinë. Kostot ekonomike të ndryshimit klimatik janë të pallogaritshme dhe mund të shkaktojnë kthime politike brenda dhe mes shteteve, si konkurrencë për burimet dhe lehtësimin e humbjeve të shkaktuara.

Në të kaluarën, klima në tokë ndryshoi me kalimin e kohës përmes proceseve natyrore; mes tjerash edhe atyre vullkanike, marinës dhe meteorëve. Megjithatë, eksitojnë dëshmi të forta, të cilat sugjerojnë se ndryshimet e tanishme në tokë nuk mund të shpjegohen vetëm me anën e variacioneve natyrore. Njerëzit, me djegien e derivateve fosile, shpyllëzimin dhe zhvillimin industrial po e ndryshojnë përbërjen e atmosferës, duke prishur balancimin e procesit natyror me emetimin e gazrave me efekt serë (*shih shtojcën 1*) dhe ndryshimin e klimës.

### 1.2 EFEKTI SERRË

Toka është e rrethuar nga një shtresë gazrash të cilët veprojnë në muret e qelqta të serave. Këto gazra i lejojnë rrezet e diellit të depërtojnë, por njëkohësisht i ndalin një pjesë të nxehtësisë nga humbja. Ky është një proces natyror dhe këto “gazra me efektin serë” (GES), të cilat kryesisht përmbajnë dyoksid karboni (CO<sub>2</sub>) dhe avull, e mbajnë ngrohtësinë e duhur të planetit e cila mundëson zhvillimi e jetës. GES, të cilat përbejnë vetëm 1% të atmosferës së tokës, e mbajnë tokën diku rreth 30°C më ngrohtë sesa do të ishte në të kundërtën. Ky efekt, siç u përmend më lart, ishte ndryshuar përmes proceseve natyrore. Meqë revolucioni industrial ka filluar në shekullin 18<sup>th</sup>, sasia e GES, e posaçërisht CO<sub>2</sub>, të cilët janë liruar në atmosferë është rritur për 35%<sup>1</sup>. Sot, niveli i dyoksidit të karbonit në atmosfere, është me i larti brenda 650,000 viteve të fundit.

### 1.3 PSE JANË NGRITUR EMETIMET E GES-IT?

Njerëzit janë duke ndikuar në rritjen e nivelit të përqendrimit të GES-it në atmosferë përmes 3 veprimeve kryesore:

1. **Djegia e karburanteve fosile** siç është qymyri, vaji dhe gazi natyror për të gjeneruar nxehtësi dhe elektricitet, fuqi transportuese dhe punë industriale.

---

<sup>1</sup> Source: Environment Knowledge for Change, <http://www.grida.no/>

2. **Shpyllëzimi** në masë të madhe, për të përmbushur kërkesat për energji dhe stili i jetës. Lisat janë të rëndësishëm sepse absorbojnë CO<sub>2</sub>, duke reduktuar nivelin e tij në atmosferë. Po ashtu, vendpunishtet bujqësore dhe industriale të cilat shpesh zëvendësojnë pyjet, bëhen burim i emetimit të GES-it. Paneli ndërqeveritar mbi ndryshimet klimatike (IPCC) vlerëson se shpyllëzimi është përgjegjës për 5.9 miliard tonelata të CO<sub>2</sub> për çdo vit, ose 18% e emetimit global të CO<sub>2</sub>.
3. **Rritja globale e popullatës** po shpie drejtë rritjes së kërkesës për ushqim, blegtori dhe energji, e cila si përgjigje shpie në rritjen e emetimit. Njerëzit prodhojnë CO<sub>2</sub> vetëm duke frymuar. Në fillim të shekullit 19, atëherë kur edhe filloi revolucioni industrial, bota kishte me pak se një miliard banorë. Në vitin 2009, besohet të ketë arritur në shtatë miliardë.

Si rezultat i ndikimit njerëzor, toka është ngrohur në mënyrë alarmuese. Gjatë shekullit XX, temperaturat mesatare të sipërfaqes së tokës janë ngritur për pothuajse 0.75°C. Një raport i IPCC i vitit 2007, thekson se ngritja e temperaturave është e padiskutueshme. Sipas IPCC dhe shumë shkencëtarëve të njohur, nëse nuk mund të trajtojmë ngrohjen globale dhe ndryshimin klimatik, temperaturat mesatare të sipërfaqes së tokës do të mund të ngriten mes 1.8-4.0°C gjatë shekullit XXI, por mund të ngriten edhe për 6.4°C<sup>2</sup>. Ndikimi që një ngritje e tillë do të kishte mbi popullsinë do të ishte shkatërruese, në veçanti për të varfërit dhe të dobëtit.

#### ANGAZHIMI NDËRKOMBËTAR PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Shkencëtarët dhe aktivistët mjedisor, të cilët në vitin 1980 kanë bërë përpjekje për të ngritur vetëdijen rreth ngrohjes globale, janë përballur me një skepticizëm të konsiderueshëm. Oponentët kanë thënë se klima e botës gjithnjë ka pësuar ndryshime. Megjithatë, organi në zhvillim i dëshmimeve për ndryshimet klimatike antropogjene filloi të bindë më shumë njerëz dhe sot kjo gjë pranohet nga shumë dhe i kushtohet vëmendje në të gjitha nivelet e shoqërisë. Si rezultat i kësaj, është filluar një proces nën protektoratin e Kombeve të Bashkuara, për bashkimin e qeverive për të trajtuar problemin. Ky proces është një betejë në rritje e sipër e cila është larg nga përfundimi.

Në vitin 1988, Paneli ndërqeveritar për ndryshimet klimatike është krijuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedis dhe nga Organizata Botërore për Meteorologji për të vlerësuar njohuritë shkencore mbi ngrohjen globale. Raporti i tij i parë, në vitin 1990 tregoi se ekzistonte një konsensus i gjerë ndërkombëtar se ndryshimet klimatike ishin të vërteta dhe të ndikuara nga veprimtaritë njerëzore.

Ky raport ka çuar në krijimin e një konvente ndërkombëtare për ndryshimet klimatike që është nënshkruar prej më shumë se 150 shtete në samitin për botën, të mbajtur në vitin 1992 në Rio de Janeiro. Ky ka qenë takimi i parë i gjerë zyrtar mbi ndryshimet

---

<sup>2</sup> IPCC Raporti i 4 për vlerësim 2007, "ndryshimi klimatik 2007: Baza e shkencës së fizikës"

klimatike (shihni shtojcën 2) dhe ka çuar në krijimin e Kornizën e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1994.

Në këtë konventë është miratuar që shtetet e zhvilluara duhet të marrin përgjegjësi për uljen e emetimeve të gazrave të efektit serë. Këtu ishte i qenësishëm fakti se shtetet e zhvilluara ishin emetuesit primar të gazrave me efekt serë gjatë shekullit të mëparshëm dhe se stabilizimi i emetimeve do të ishte më i vështirë për shtetet në zhvillim.

Ndonëse kjo konferencë përfaqësoi hapin e parë drejt trajtimit të ndryshimeve klimatike përmes bashkimit të komunitetit ndërkombëtar, kishte ndarje mes shteteve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim mbi atë se si të trajtohet ky ndryshim. Për më tepër, konventa ishte në baza vullnetare, nuk ishin krijuar kufij apo dispozita të detyrueshme mbi emetimet. Në vend të kësaj, konventa bëri thirrje për azhurnime apo 'protokolle' që do të caktonin objektiva të detyrueshme për emetime.

Konventa UNFCCC në Rio ishte paraardhëse e Protokollit të Kiotos. Para zhvillimit të protokollit, janë mbajtur një numër takimesh përgatitore të njohura si konferenca për palët në Bon (1995) dhe Gjenevë (1996).

### **1.5 PROTOKOLLI I KIOTOS**

Në muajin dhjetor të vitit 1997 në Kioto të Japonisë u takuan liderët botërorë dhe pas shumë debateve u përfundua në nënshkrimin e një protokollit të njohur si Protokollit i Kiotos. Ky është një traktat ndërkombëtar për mjedisin me synimin e arritjes së "stabilizimit të koncentrimëve të gazrave me efekt serë në atmosferë në një nivel që do të parandalonte ndërhyrjen e rrezikshme antropogjene në sistemin klimatik"<sup>3</sup>. Palët nënshkruese u pajtuan se:

- Pjesa më e madhe e emetimeve globale historike dhe të tanishme të gazrave me efekt serë ishte në shtetet e zhvilluara.
- Emetimet për kokë banori në shtetet në zhvillim ishin ende relativisht të ulëta.
- Pjesa e emetimeve globale që del nga shtetet në zhvillim do të rritet për t'i plotësuar nevojat sociale dhe ato zhvillimore.

Bazuar në këto mirëkuptime, Protokollit themeloi zotime të detyrueshme ligjërish për uljen e katër gazrave me efekt serë (dioksidi i karbonit, metani, oksidi i azotuar dhe heksafloridi sulfurik) dhe dy grupe të gazrave (karbonet hidroflorike dhe karbonet perflorike) të prodhuara nga shtetet e industrializuara (shtojca I) si dhe zotimet e përgjithshme për të gjitha shtetet anëtare të Konventës UNFCCC.

Sipas Protokollit, 37 shtete të zhvilluara, janë pajtuar që të ulin emetimet e tyre kolektive të gazrave me efekt serë për 5.2% nga nivelet e tyre të vitit 1990. Kufizimet

---

<sup>3</sup> Neni 2 i Protokollit. Teksti i plotë mund të gjendet në [http://unfccc.int/essential\\_background/convention/background/items/2853.php](http://unfccc.int/essential_background/convention/background/items/2853.php)

shtetërore janë radhitur nga një ulje prej 8% për Bashkimin Evropian, 7% për Shtetet e Bashkuara, 6% për Japoninë dhe 0% për Rusinë dhe kanë lejuar një ngritje prej 8% për Australinë dhe 10% për Islandën.<sup>4</sup> Shtetet në zhvillim nuk kanë qenë të detyruara që të ulin emetimet e tyre. Megjithatë, sipas nenit 10, udhëheqësit e tyre janë pajtuar për të përmirësuar cilësinë e tyre të raportimit mbi emetimet e gazrave me efekt serë dhe për të “formuluar, zbatuar, publikuar dhe azhurnuar rregullisht programet shtetërore që përmbajnë masa për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe masave për të lehtësuar përshtatjen adekuate ndaj ndryshimeve klimatike”<sup>5</sup>.

Protokolli kishte për qëllim uljen e emetimeve nga grupi i gjashtë gazrave me efekt serë deri në vitin 2008-2012 (e njohur si ‘periudha e parë e zotimit’), e llogaritur si një mesatare gjatë këtyre pesë viteve. Uljen në tri të gazrave më të rëndësishëm- dioksidi i karbonit, metani dhe oksidi nitrik- maten kundrejtë vitit bazë që është viti 1990.

Sipas nenit 25, Protokolli do të hynte në fuqi vetëm tre muaj pas ratifikimit nga 55 shtetet e zhvilluara. Kjo ka ndodhur në muajin shkurt të vitit 2005, pas ratifikimit të Rusisë në nëntorin e kaluar. Deri më sot, 187 shtete e kanë ratifikuar Protokollin.<sup>6</sup> Fatkeqësisht, Shtetet e Bashkuara nuk janë në këtë mes dhe emetuesit e mëdhenj të gazrave me efekt serë, pra Kina dhe India, nuk kërkohen që të ulin emetimet e tyre për shkak të statusit si ‘shtete në zhvillim’.

### **1.5.1 PROTOKOLLI I KIOTOS: MEKANIZMAT PËR ULJEN E EMETIMEVE TË GAZRAVE ME EFEKT SERË**

Protokolli i Kiotos i ka kufizuar shumicën e shteteve të zhvilluara për të ulur emetimet e gjashtë gazrave më të mëdhenj me efekt serë përmes një sistemi të ‘mbulimit dhe tregtimit’, ku emetimet e përgjithshme mbulohen dhe mund të bëhet tregti me të drejtat për ndotje. Gjithashtu ishin paraqitur tre mekanizma të bazuara në treg, duke ju ofruar kështu disa shteteve më shumë fleksibilitet mbi atë se si të ulen emetimet e tyre përmes krijimit të asaj që tani njihet si ‘tregu i karbonit’:

**1. Mekanizmi për Tregtimin e Emetimeve (MTE):** Kjo ju mundëson emetuesve (shteteve, kompanive apo objekteve) blerjen e emetimeve nga emetuesit e tjerë apo shitjen e tyre tek ata.

**2. Mekanizmi i Pastër për Zhvillimin (MPZh):** Kjo ju mundëson shteteve të zhvilluara uljen e emetimeve jashtë vendeve në shtetet që nuk janë palë të Protokollit të Kiotos që bazohen në zotimet e tyre ligjore. Qëllimi i kësaj është që të ndihmohen shtetet e industrializuara në uljen e kostove dhe përmbushjen e objektivave të tyre përmes arritjes së uljeve gjëkund.

---

<sup>4</sup> Program ii OKB-së për Zhvillim (1997-12-11). "Shtetet e industrializuara duhet t'i ulin emetimet e gazrave me efekt serë deri në 5.2%". Komunikatë për shtyp. <http://unfccc.int/cop3/fccc/info/indust.htm>

<sup>5</sup> Neni 4.1 (b) i Protokollit.

<sup>6</sup> Sipas dhjetorit 2009

**3. Zbatimi i Përbashkët (ZP):** Kjo u mundëson shteteve të zhvilluara marrjen e kredive të emetimeve, që mund të përdoren për objektivat e tyre të emetimeve përmes pjesëmarrjes në projekte të caktuara me shtetet e tjera të zhvilluara. Projektet e ZP-së duhet të miratohen nga të gjitha shtetet që marrin pjesë në projekt dhe duhet të ulin emetimet e gazrave me efekt serë ose të kontribuojnë në largimin e tyre.

Shpresat kanë qenë që ky mekanizëm të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm përmes investimeve dhe bartjes së teknologjisë si dhe përfshirjen e sektorit privat për të zhvilluar sisteme për zvogëlimin e kostove për uljen e gazrave me efekt serë.

### **1.5.2 PROTOKOLLI I KIOTOS: SUKSES APO DËSHTIM?**

Shumë njerëz e shohin Protokollin e Kiotos si një dështim. Arsyet e tyre janë se ky protokoll thjesht nuk ka bërë mjaft për të siguruar që shtetet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të ulur emetimet dhe arritur objektivat. Është e vërtetë se shumë palë nënshkruese kanë bërë shumë pak. SHBA-të, që janë ndër emetuesit më të mëdhenj, asnjëherë nuk e kanë ratifikuar Protokollin. Udhëheqësit nga politika dhe bizneset në SHBA, Kinë dhe Indi dhe emetuesit e tjerë kyç, kanë qenë në mënyrë të kuptueshme të shqetësuar rreth kostove ekonomike të uljes së emetimeve të tyre dhe zhvillimit të teknologjive dhe procedurave të reja për emetime të ulëta.

Një arsye tjetër e perceptimit të Protokollit si të dështuar ka qenë pjesëmarrja jo e plotë dhe objektivat e diferencuara, që kanë krijuar një fushë loje 'jo të drejtë'. Gjithashtu objektivi i Protokollit për uljen e emetimeve për 5.2% paraqet vetëm një pjesë të uljeve që nevojiten për të ndaluar ndryshimet klimatike antropogjene, duke pasur parasysh ngritjen e vazhdueshme dhe të përsheptuar të emetimeve të gazrave me efekt serë në dekadën e fundit. Disa mendojnë se Protokollin vetëm cakton objektiva dhe i injoron masat e nevojshme teknike. Për më tepër, nuk ekziston ndonjë ndëshkim për mos respektim të tij.

Protokollin shpeshherë është shikuar si optimist për atë që ka kërkuar të arrihet në një periudhë kohore të shkurtër. Gjithashtu, disa mund të thonë se ky Protokoll ka kërkuar shumë për shtetet e zhvilluara që mbajnë përgjegjësinë dhe kostot kryesore dhe shumë pak nga shtetet në zhvillim.

Pavarësisht këtyre pikave negative, është e rëndësishme të mbahet në mend se Protokollin i ka shtyrë udhëheqësit e botës dhe popullsinë që të mendojnë seriozisht rreth problemit të ngrohjes globale. Ndërgjegjësimi publik, është rritur rreth efekteve të tij, në mënyrë të jetesës dhe të ardhmen dhe është arritur në konsensusin se duhet të ndërmerret diçka. Si i tillë Protokollin së paku ka përqendruar vëmendjen njerëzore tek ky kërcënimin në të ardhmen.

Meqë viti 2012, fundi i periudhës së parë të zotimit, po afrohet është e qartë se objektivat e emetimeve nuk do të arrihen. Kështu që përqendrimi është zhvendosur në takimin për konventën UNFCCC që do të mbahet në dhjetor të vitit 2009 në Kopenhagë.

### **1.6 PAS KIOTOS**

Edhe para hyrjes në fuqi të Protokollit të Kiotos në vitin 2005, Konventa UNFCCC filloi të mendojë se çfarë ndryshimesh në Protokollin e Kiotos do të mund të siguronin një reagim më efektiv ndaj ndryshimeve klimatike dhe të zgjidhte mosmarrëveshjet mes palëve të saj, që në masë të konsiderueshme janë parë përmes tri konferencave të palëve.

Në konferencën e palëve që u mbajt në Bali në vitin 2007, pavarësisht mosmarrëveshjeve të shumta mes palëve, u krijua 'harta e rrugës'. Kjo filloi një proces të ri të negociatave, për të përfunduar në Kopenhagën në vitin 2009, ku u bënë të njohura dy çështje specifike që kanë pasur nevojë të trajtohen para vitit 2009:

- Veprimi për përshtatjen me pasojat negative të ndryshimeve klimatike, siç janë thatësitat dhe vërshimet.
- Vendosja e teknologjive miqësore për klimën dhe financimi i përshtatjes dhe i masave lehtësuese.

Në konferencën e palëve në Poznan në vitin 2008, është arritur një lloj progresi mbi çështjet e lartpërmendura, ku vlen të theksohet themelimi i Fondit të Përshtatjes për të financuar projekte në ato shtete në zhvillim që janë posaçërisht vulnerabil ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe çështjet e shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve. Megjithatë, objektivat afatgjatë për uljen e emetimeve dhe për mekanizmat që mbartin teknologjitë të cilat u mundësojnë shteteve në zhvillim lëvizjen drejt ekonomive me karbon të ulët, nuk janë krijuar.

Në mars të vitit 2009, konferenca e fundit e palëve para konferencës së Kopenhagës është mbajtur në Bon. Aty ishin filluar negociatat për një draft-marrëveshje si përgatitje për konferencën e dhjetorit. Draft-teksti zbuloi një ndarje të vazhdueshme mes shteteve të pasura dhe atyre të varfra. Shtetet në zhvillim u kërkuan homologëve të tyre të industrializuar një zotim për ulje të konsiderueshme të CO<sub>2</sub> dhe ofrimin e ndihmës financiare, ndonëse nuk ka pasur zotime.

Ndonëse nuk janë të ndërlidhura drejtpërdrejtë me procesin e konventës UNFCCC, janë bërë dy zhvillime ku shtetet e industrializuara kanë marrë iniciativa për të shqyrtuar mundësitë e trajtimit të ndryshimeve klimatike.

Në fund të vitit 2008, Bashkimi Evropian shpalli synimin e tij për uljen e emetimeve të gazrave me efekt serë për 20% deri në vitin 2020, dhe për ngritjen e përdorimit të energjisë së ripërtërirshme dhe efikasitetin e energjisë për 20%. BE-ja është munduar që t'i inkurajojë shtetet siç janë SHBA-të, Kina, Rusia dhe India të ndjekin procesin dhe kushdo që sheh zhvillimin e termocentraleve me erë nëpër Evropë mund të shohë se shtetet anëtare të BE-së e kanë marrë me seriozitet çështjen e energjisë së ripërtërirshme.

Më 9 korrik 2009, në L'Aquila, Itali, udhëheqësit e shteteve të industrializuara G8 u takuan dhe u pajtuan për përpjekjet për të kufizuar ngrohjen globale në 2°C mbi nivelet paraindustriale deri në vitin 2050. Sipas konsensusit shkencor, ky limit prej 2°C do të ishte minimumi absolut i kërkuar nëse bota dëshiron të shmangë ndonjë ndryshim klimatik katastrofik. Udhëheqësit e G8-ës u pajtuan për një ulje prej 80% të emetimeve

për shtetet e zhvilluara dhe një ulje prej 50% për shtetet në zhvillim, me qëllim përgjysmimin e emetimeve globale deri në vitin 2050.

Ata gjithashtu u pajtuan dhe u zotuan për masa efikase për energji dhe për përkrahjen e teknologjive për energji të ripërtëritshme dhe përdorimin e pastër të thëngjillit. Ata kanë theksuar se duhet të ulen subvencionimet që inkurajojnë konsumin e energjisë me karbon intensiv, ku në të njëjtën kohë duhet të vendoset korniza rregullative për përkrahjen e kalimit në ekonomi me karbon të ulët. Përveç kësaj, tregjet e karbonit u pranuan si një nga mënyrat më kosto efektive të ngritjes së investimeve në efikasitetin e energjisë, energjinë e ripërtëritshme dhe teknologjitë e pastra.

Të gjitha këto hapa kanë shërbyer si hyrje për konferencën e UNFCCC në dhjetor 2009 në Kopenhagën, ku detyra mbetet rregullimi i dështimeve dhe të metave të Protokollit të Kiotos. Zhvillimet e rëndësishme për t'u marrë parasysh janë:

- Uljet e emetimeve të gazrave me efekt serë nga shtetet e zhvilluara janë kufizuar, kryesisht për shkak të mosveprimit nga Shtetet e Bashkuara.
- Ka mundësi që objektivat e Protokollit të Kiotos për emetimet e gazrave me efekt serë për shtetet e zhvilluara të mos përmbushen.
- Sipas raportit të IPCC të vitit 2007, nëse temperatura e planetit ngritet për më shumë se 2°C mbi nivelet e paraindustriale, do të ketë fenomene klimatike më ekstreme.
- Emetimet e gazrave me efekt serë në vend që të ulen janë duke u ngritur.
- Ulja e emetimeve të gazrave me efekt serrë më nuk është përgjegjësi vetëm për shtetet e zhvilluara sepse shtetet dhe ekonomitë në zhvillim janë duke shtuar emetimet, ku disa (kryesisht Kina dhe India) janë duke emetuar më shumë sesa homologët e tyre të zhvilluara.
- Ndarja mes shteteve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim është duke vazhduar, ku shtetet e zhvilluara shpeshherë nuk janë të gatshme të veprojnë, duke cituar ndikimet negative ekonomike dhe shtetet në zhvillim nuk janë të gatshme të veprojnë derisa shtetet e industrializuara të bartin barrën.
- Nuk ka konsensus nëse shtetet në zhvillim duhet të obligohen për t'u zotuar për marrëveshje detyruese pavarësisht pozitive të shpeshta të ekonomisë së dobët.
- Burimet alternative të energjisë duhet të hulumtohen, zhvillohen dhe shfrytëzohen.

Bazuar në normat e tanishme të emetimeve të gazrave me efekt serë, koha është duke kaluar për arritjen e një marrëveshje për luftimin e përbashkët të ndryshimeve klimatike para se fatkeqësitë të bëhen të paevitueshme. Në një fjalim në Seul në gusht 2009, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Ban Ki-Moon, theksoi këtë shqetësim, duke thënë se kanë mbetur "më pak se 10 vite për të ulur emetimet e gazrave me efekt serë nëse dëshirojmë të mënjanojmë pasoja katastrofike për njerëzit dhe planetin".

## **KAPITULLI 2 NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE KOSOVA**

---

### **2.1 KOSOVA SOT**

Kosova ka shpallur pavarësinë e saj me 17 shkurt 2008, edhe pse akoma nuk ka fituar njohje të plotë ndërkombëtare të statusit të saj si shtet i pavarur. Çka është më e rëndësishmja, Kosova nuk është njohur nga Kombet e Bashkuara për shkak të kundërshtimeve nga ana e Serbisë, Kinës dhe Rusisë, dy të fundit që janë anëtare të përhershme në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kosova është ende duke kaluar tranzicionin nga një ekonomi socialiste në një model të bazuar në treg. Që nga ndërhyrja ushtarake e NATO-s në vitin 1999, që u bë për të ndaluar përpjekjet serbe për largimin e shqiptarëve nga Kosova, Kosova ka operuar nën udhëheqjen e Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) deri në pavarësinë e saj në vitin 2008.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, Kosova ka marrë mbështetje substanciale nga donatorë ndërkombëtarë për ta zhvilluar vendin. Kosova, gjithashtu ka përfituar nga të ardhura substanciale nga të afërmit që jetojnë jashtë saj. Ekonomia e Kosovës, megjithatë, mbetet e dobët dhe e paaftë të mbajë veten pa ndihmë të jashtme. UNMIK-u dhe organizatat ndërkombëtare donatore, kanë punuar me Kosovën për të themeluar institucionet qeveritare dhe sistemin ligjor. Dukshëm, si rezultat i përfshirjes së tillë ndërkombëtare dhe shpresës së Kosovës për t'u bërë anëtare e BE-së në të ardhmen, një pjesë e madhe e legjislacionit është hartuar që të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Gjatë gjithë periudhës transitore të Kosovës, mjedisi nuk ka qenë prioritet i lartë i donatorëve dhe as i qeverisë së lindur të Kosovës. Çështjet mjedisore ende marrin vëmendje të kufizuar dhe janë në fund të listës së prioriteteve në agjendën e Qeverisë, duke pasur parasysh problemet tjera dhe mungesën e resurseve. Si rezultat i kësaj, Kosova vazhdon të vuajë nga probleme serioze mjedisore përfshirë mungesën e ujit dhe ndotjen e tij, mbetjet industriale, degradimin e tokës, shpyllëzimin dhe prerjet ilegale, si dhe ndotjen e ajrit.

Ndryshimet klimatike janë me siguri një problem më pak i dukshëm tani për tani, por së fundmi është bërë më i rëndësishëm. Megjithatë, kjo temë nuk mungon nga debatet dhe brengat publike dhe gjendet jashtë vëmendjes së qeverisë.

### **2.2 NDJESHMËRIA E KOSOVËS**

Ekspertët e ndryshimeve klimatike parashikojnë që gati e gjithë Evropa do të ndikohet negativisht nga ngrohja globale. Evropa lindore dhe ajo juglindore, përfshirë Ballkanin, parashikohet të preket për shkak të klimës relativisht të thatë që ka. Disa nga shtetet në këto rajone mund të konsiderohen të jenë në zhvillim dhe kanë mungesa të kapaciteteve financiare, institucionale dhe njerëzore për t'u ballafaquar me ndryshimin e klimës. Shtetet e Ballkanit, tanimë, duket se po përjetojnë efektet e temperaturave në ngritje, me thatësira, zjarre pyjesh, humbje të të korrave dhe dëmtime nga stuhitë. Autoritetet dhe popullata e Kosovës, duhet të shohin ndryshimin e klimës si kërcënim madhor për

vendin e tyre dhe për Ballkanin në përgjithësi. Ka një numër shkaqesh për t'u shqetësuar, disa nga të cilat do të ekzaminohen më poshtë.

### **2.2.1 NDRYSHIMET KLIMATIKE**

Kosova është vend shumë i vogël me klimë dominuese kontinentale. Ka verëra të ngrohta dhe dimra të ftohtë me ndikime mesdhetare dhe alpine. Ka lartësi të pabarabarta të cilat sjellin diferenca rajonale në temperaturë dhe në shpërndarje të reshjeve. Ndryshimet klimatike mund të rrisin luhatjet tanimë ekzistuese në këtë rajon.

Është parashikuar që Kosova do të ketë temperaturë gjithnjë në rritje dhe reshje gjithnjë e më të çrregullta. Në fakt, Kosova tashmë, mund të ketë përjetuar modelet ndryshuese të motit në formë vërshimesh në vitin 2006 dhe **përmbytjesh** në vitet 2007 e 2008, kjo sipas këshilltarit për politika ujorë në Qeverinë e Kosovës, Baton Begolli. Ndryshimet e tjera parashikohet të përfshijnë shtypje të rritur të ujit dhe dëmtime në biodiversitetin dhe ekosistemet e Kosovës. Ka rrezik që, përderisa Kosova ashtu edhe fqinjët e saj të vuajnë këto efekte, mund të ketë një ngritje në tensionet rajonale, siç është parë në konfliktet mbi kontrollin e ujërave, në pjesët e tjera të botës.

### **2.2.2 ZHVILLIMI I PAQËNDRUESHËM**

Ndryshimet klimatike mund të bëjnë të vështirë ose të paqëndrueshëm zhvillimin e Kosovës. Pritet që një klimë më e ngrohtë do të reduktojë vëmendjen e nevojave bazike si uji për përdorim njerëzor dhe ujë, siguria e ushqimit dhe energjia. Lidhjet në mes të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimit të qëndrueshëm janë të forta, në veçanti për shtetet e varfra dhe ato në zhvillim.

### **2.2.3 RREZIQET SHËNDETËSORE**

Ndryshimet klimatike jo vetëm që do të sjellin një botë më të ngrohtë, por gjithashtu do të vendosin bazën për një botë më të pashëndetshme. Me një klimë të ndryshueshme dhe përfundimisht më të ngrohtë, popujt rreth botës do të bëhen më të ndjeshëm ndaj vdekshmërisë nga të nxehtit, sëmundjeve nga ndotja e ajrit, sëmundjeve infektive dhe keqtrajtjes. Kështu, Kosova do të jetë në rrezik nga krizat shëndetësore që kanë të bëjnë me klimën, nga valët e ngrohta dhe uria, deri të vërshimet dhe sëmundjet e bartura nga uji.

## **2.3 KONTRIBUTI I KOSOVËS NË NDRYSHIMET KLIMATIKE**

Kosova, edhe pse relativisht e vogël në territor dhe popullatë, është kontribuuese e proceseve të ndryshimeve klimatike. Ndoshta për shkak të madhësisë, ajo ka një kontribut të lartë për kokë banori. Ka tri fusha kryesore ku ajo kontribon në goditjen e klimës së tokës.

### **2.3.1 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE**

Kosova është e bekuar dhe e nëmur që ka 14.7 miliardë ton linjit dhe radhitet e 5-ta në botë për rezerva të vërtetuara si mjeti i saj kryesor për zhvillim. Përdorimi i këtyre

resurseve për të prodhuar energji do të rrisë zhvillimin ekonomik dhe do të kontribuojë edhe për pjesën tjetër të rajonit përmes eksportimit të tepricave të energjisë. Në anën tjetër, ajo do të rrisë në masë të madhe emetimet e gazrave në Kosovë. Tani për tani, burimet e energjisë në Kosovë (98%) vijnë nga termocentralet ekzistuese që funksionojnë me linjit (Kosova A dhe Kosova B). Sipas Vlerësimit Strategjik Mjedisor të financuar nga Banka Botërore, Kosova A dhe Kosova B kanë emetuar 5.8 milion ton CO<sub>2</sub> në vitin 2005. Në vitin 2006, Departamenti I Mjedisit I Korporatës Energjetike të Kosovës ka raportuar që Kosova A ka emetuar rreth 1.5 milion ton CO<sub>2</sub> dhe Kosova B rreth 3.6 milion ton.

Sot, këto dy termocentrale, janë në nevojë dëshpëruese të zëvendësimit ose modernizimit, për shkak të teknologjisë së vjetër dhe joefikase. Ato janë ndotës të mëdhenj që emetojnë hi dhe gazra në sasi të mëdha dhe nuk janë në gjendje të prodhojnë energji të mjaftueshme për të përballuar nevojat e Kosovës për energji. Tani, Kosova A është propozuar të mbyllet dhe qeveria është në proces të finalizimit të planeve për zhvillim të një termocentrali të ri me kapacitet prej 2,100MW, me shpresë që do të mbulojë edhe nevojën e brendshme për energji dhe gjithashtu do t'i mundësonte shtetit të ri të bëhet eksportues i energjisë për Ballkanin dhe me gjerë.

Njësia e parë e Kosovës C pritet të fillojë nga puna në vitin 2014 me një ose dy njësi të reja që do instalohen me pas në intervale 18 mujore. Prodhimi fillestar do të jetë në mes 900 dhe 1,000 MW. Sipas kalkulimeve të Bankës Botërore<sup>1</sup>, nëse Kosova A mbyllet dhe Kosova C arrin kapacitetin e saj të plotë përkrah Kosovës B, sasi shumë më të mëdha që arrijnë rreth 22.5 milion ton të CO<sub>2</sub> dhe gazra tjera do të emetohen. Kosova pritet të përdorë linjitin e saj si burim kryesor të energjisë për së paku 40 vitet e ardhshme.

### **2.3.2 AUTOMJETET**

Veturat dhe kamionët e rinj kanë të përfshirë teknologji për të reduktuar emetimet e dëmshme. Megjithatë, shumica e automjeteve në Kosovë janë modele të vjetra që emetojnë sasi të mëdha të gazrave përmes sistemeve të tyre nxjerrëse. Përderisa nuk ka të dhëna nga ana e qeverisë, llogaritë e përgjithshme tregojnë se, 10% e të gjitha gazrave të emetuara, vijnë nga automjetet. Llogari jozyrtare nga Agjencia Kosovare për Mbrojtje të Mjedisit, tregojnë që përafërsisht 5.5 milion ton CO<sub>2</sub> emetohet nga automjetet e Kosovës.

Edhe pse Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit (MTT) dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MESP) duhet të jenë përgjegjëse për të dhënat e emetimeve të rreth 220,000 automjete te regjistruara në Kosovë, një përfaqësues nga MTT tha që nuk ka të dhëna<sup>2</sup>. Për më tepër, në vitin 2002, rreth 30,000 ton dizel dhe 25,000 ton benzinë janë importuar pa asnjë kontroll të kualitetit.

### **2.3.3 SHPYLLËZIMI**

Rreth 40% e territorit të Kosovës që është 10,904km<sup>2</sup> është i pyllëzuar. Megjithatë, që nga përfundimi i luftës, dhe me siguri edhe më herët, ka ndodhur një shpyllëzim i konsiderueshëm si rezultat i prerjeve, – një pjesë e madhe e saj jologjore dhe e pamonitoruar – për dru ngrohjeje dhe ndërtimi. Sipas Departamentit të Pyjeve të Kosovës, rreth 222,000m<sup>3</sup> drunj eksploatohen çdo vit.

Pyjet e Kosovës duhet të shihen si asete që duhen ruajtur. Ato janë të rëndësishme për rolin e tyre kyç në absorbimin e CO<sub>2</sub>. Reduktimi i sipërfaqeve pyjore rezultojnë në nivele më të mëdha të CO<sub>2</sub> në atmosferë që në kthim rezultojnë në temperatura më të larta.

Krahas shpyllëzimit të qëllimshëm, Kosova humb afërsisht 40km<sup>2</sup> sipërfaqe pyjore, nga zjarret çdo vit. Nëse temperaturat rriten dukshëm, shpeshësia dhe dëmi nga këto zjarre do të rritet.

## **2.4 OBLIGIMET KUSHTETUESE**

Mund të debatohet që qeveria e Kosovës ka obligim kushtetues të luftojë ndryshimet klimatike, si pjesë e kërkesave të tyre për të mbrojtur fëmijët e vendit, siç është shprehur në pikat 1 dhe 4 të nenit 50. Qeveria duhet të japë “mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për ...”mirëqenien” e fëmijëve të Kosovës, dhe duhet të sigurojë që “të gjitha veprimet” që do të ndërmerren “...nga autoritetet publike ose private në lidhje me fëmijët, duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve”.

Kjo vendosë përgjegjësi në ballafaqimin e qeverisë me çështjen e ndryshimeve klimatike, pasi që kjo do të jetë në interesin më të mirë për fëmijët e Kosovës dhe për gjeneratat e ardhshme. Neni 52, në veçanti pika 3, thërret institucionet publike të konsiderojnë mjedisin në proceset e vendim-marrjes. Pasi që ndryshimet klimatike kanë të bëjnë me mjedisin, veprime duhet të ndërmerren për t’u ballafaquar me të.

## **2.5 BALLAFAQIMI ME NDRYSHIMET KLIMATIKE**

Disa mund të mendojnë që Kosova nuk ka obligime as kërkesa që tani të veprojnë në lidhje me ndryshimet klimatike. Kosova nuk ka marrë pjesë e as nënshkruar Protokollin e Kjosës. As nuk është e obliguar t’i nënshtrohet caqeve të BE-së për Energji dhe Klimë (shih faqe 5). Përderisa kjo është teknikisht edhe ligjërish e vërtetë, pa marrë parasysh mosanëtarësimin në OKB dhe pasigurinë rreth të ardhmes së saj në BE, shteti i Kosovës ka përgjegjësi morale ndaj popullit të vet dhe pjesës tjetër të botës, për t’u përfshirë në problem.

Për udhëheqësit e Kosovës, prioritetet ekonomike kanë tejkaluar brengat mjedisore deri tani, dhe ndryshimet klimatike kanë pasur pak vëmendje nga MMPH dhe nga liderët politik e civil, në përgjithësi. Kjo konfirmohet kur shohim fondet e alokuara për çështje mjedisore, që janë vetëm 0.1% e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës. Në vitin 2009, kjo ishte rreth €13 milion, vetëm një pjesë e vogël e së cilave u dha për iniciativa që kanë të bëjnë direkt me ndryshimet klimatike.

Përderisa fqinjët e saj, janë pothuajse nga blloqet fillestare që e luftojnë ndryshimin klimatik, Kosova është ende qartazi në fund të listës ( shih shtesën 3). Të gjitha shtetet e Ballkanit përveç Kosovës, kanë ratifikuar Protokollin e Kjosës dhe përtej kësaj, kanë

ndërmarrë edhe hapa tentativë. Meqë Kosova nuk është anëtare e UNFCCC, ajo me siguri nuk mund të ratifikojë në mënyrë ligjore asnjë marrëveshje që del nga Kopenhaga, edhe pse kjo është një rrugë ligjore që ja vlen të eksplorohej. Kosova është, megjithatë, nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, që është i përkushtuar të përpiqet të vërë caqe dhe korniza për reduktime qenësore dhe afatgjata të gazrave, duke ecur paralelisht me caqet e Konventës së Kjotos. Tutje, Kosova nuk ka legjislacion të zgjeruar mjedisor, që të paktën përmend ndryshimet klimatike.

### **2.5.1 KORNIZA LIGJORE**

Kuvendi i Kosovës ka kaluar rreth 40 ligje që kanë të bëjnë në një mënyrë me luftimin e ndryshimeve klimatike, shumë nga të cilët janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, edhe pse shumica prej tyre tani janë të pazbatuara.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit përfshin një numër instrumentesh ligjore për të siguruar zbatimin e tij në Kosovë dhe për të siguruar promovim efektiv të një mjedisi të shëndoshë.

Ligji për Mbrojtjen e Ajrit, jep një bazë ligjore për rregullimin e kualitetit të ajrit dhe definojnë të drejtat dhe detyrat relevante në linjë me standardet e BE-së dhe WHO-së.

Ligji për Kanalizimet, jep rregullat për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përdorimin e burimeve ujore të Kosovës. Ai gjithashtu promovon mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, eksploatimi dhe keqtrajtimi.

Ligji për Administrimin e Mbeturive, krijon një bazë ligjore për t'u marrë me mbetjet, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik dhe parandalimit të akumulimit.

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës, definojnë parimet e mbrojtjes së natyrës dhe rregullon përdorimin e qëndrueshëm të saj, si dhe promovon revitalizimin e zonave natyrore të dëmtuara, si dhe kompensimet për dëmet e pësuar.

#### **Ligje tjera relevante përfshijnë:**

Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit

Ligji për Mbeturinën

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

Ligji për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit

Ligji për Kanalizimet e Kosovës

Ligji për Parandalimin dhe Kontrollimin e Ndotjes	Ligji për Mbrojtjen e Llojlojshmërisë Bimore
Ligji për Mbrojtjen nga Ndotja e Ajrit	Ligji për Bletari
Ligji për Pyjet e Kosovës	Ligji për Biologjinë Organike
Ligji i Kosovës për Farërat	Ligji për Ngrohje Qendrore
Ligji për Plehrat artificiale	Ligji për Ushqime
Ligji për Rrugët	Ligji për Partneritete Publiko-Private dhe për koncesione në infrastrukturë dhe procedurat e tyre
Ligji për Planifikimin Hapësinor	
Ligji për Pesticidet	Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Ligji për Inspektimet Sanitare	Ligji për Produktet Biocidike
Ligji për Energji	
Ligji për Energjinë Elektrike	
Ligji për Fidanët	
Ligji për Ndërtim	
Ligji për Punë nga Materiale të Çmueshme	
Ligji për Bagëtinë e Kosovës	
Ligji për Ujitjen e Tokave Bujqësore	
Ligji për Kujdesin ndaj Kafshëve	
Ligji për Materialin Ndërtimor	
Ligji për Duhanpirjen	
Ligji për Gjueti	
Ligji për Meteorologji	
Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri	
Ligji për Disenj Industrial	
Ligji për Mbrojtjen nga Katastrofat Natyrore dhe të tjera	
Ligji për Aktivitete Hidro-meteorologjike	
Ligji për Peshkim dhe Akuakulturë	
Ligji për Mbrojtjen e Bimëve	

Përkundër kësaj baze të gjerë ligjore për mjedisin, ka mungesë të legjislacionit specifik ose politikave për ndryshimet klimatike. Kështu, vetëm hapa minimal janë ndërmarrë për të qenë në përputhshmëri me standardet e BE-së dhe UNFCCC-së. MMPH ka sugjeruar që të zhvillohet një strategji në fillim të vitit 2010, edhe pse është ende e paqartë forma që kjo çështje do të marrë.

### **2.5.2 ZHVILLIMET E FUNDIT**

Nuk ka strategji për reduktim të emetimeve të gazrave e as strategji për ballafaqim me ndryshimet klimatike në përgjithësi. Në fakt, Kosova nuk ka inventar të duhur kombëtar të gazrave dhe mbetet e paqartë se cilin vit do ta zgjedhë Kosova si vitin bazik për të matur dhe krahasuar emetimet, duke pasur parasysh këtë mungesë të informatave. Një “pikë kontakti” kombëtare për ndryshim klimatik, që është e nevojshme për koordinim të çështjeve në lidhje me ndryshime klimatike, nuk është vendosur. Tutje, nuk është përcaktuar kuotë kombëtare, dhe nuk janë bërë akoma vlerësime të ndjeshmërisë së vendit dhe strategjive potenciale për zbutje.

Progres është arritur në lidhje me zhvillimin e termocentralit të ri të Kosovës. Një vlerësim i ndikimit mjedisor dhe social është kryer nga MMPH, financuar nga Banka Botërore. Meqënëse ky termocentral do të jetë burim i madh i gazrave në të ardhmen, ai është një hap i rëndësishëm.

Në fillim të vitit 2009, një Zyrë për Ndryshimet Klimatike është hapur brenda MMPH-së. Ka pasur shpresë që kjo zyrë do të prodhonte një inventar të gazrave për Kosovë, të përgatisë legjislacion efektiv dhe të komunikojë me UNFCCC-në. Nuk ka detaje specifike për buxhetin në dispozicion për këtë zyrë, vetëm dihet që fondet për këtë zyrë do të vijnë nga buxheti i MMPH-së. Megjithatë, për shkak të rrogave të vogla të përcaktuara për postet, i punësuarit i parë ka dhënë dorëheqje dhe nuk i është gjetur akoma zëvendësuesi.

Përgatitjet kanë filluar për një vlerësim gjithëpërfshirës të kualitetit të ajrit, si dhe për përpilimin, miratimin dhe zbatimin e rregulloreve për emetimet nga burimet statike dhe të lëvizshme. Një post për monitorim të kualitetit të ajrit është duke u ndërtuar dhe tri të tjera janë të planifikuara.

Sa i përket zhvillimit të resurseve të ripërtërishe, Kosova është tani duke rinovuar rreth 17 hidrocentrale për prodhim alternative të energjisë elektrike. Disa projekte për energji solare janë zbatuar për ngrohje të ujit, por jo për prodhim të energjisë. Energjia solare shihet si një zgjidhje e mirë afatgjatë për të mbuluar harxhimin e lëndëve djegëse fosile. Megjithatë, teknologjia dhe metodat e prodhimit, të nevojshme për të zhvilluar atë nuk janë as të sofistikuar dhe të lira për të qenë konkurruese në treg, ose fizibël për mjetet e kufizuara të Kosovës.

Në vitin 2009, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka iniciuar një plan për të mbjellë dy milion pemë. Pyjet, megjithatë, kërkojnë menaxhim dhe kjo është mbikëqyrur nga Ministria, që duket të jetë pak e informuar për sasinë e prerjeve ilegale dhe mungesës së mjeteve për të luftuar këtë fenomen.

Kosova ka mbajtur konferencën dhe punëtorinë e saj të parë në lidhje me çështjen e ndryshimeve klimatike në Prill 2009, me iniciativë të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe MMPH-së. Kjo ka dhënë një mundësi për ngritje të vetëdijes. Në konferencë, Ministri i MPH-së foli për rolin e rëndësishëm që Kosova duhet të ketë, përkundër së qenit vend i vogël. Në punëtori, znj. Stoycheva, këshilltare në UNDP në Kosovë, theksoi nevojën për veprim. Sugjerimet e saj përfshinë ndërmarrjen e vlerësimeve për ndjeshmërinë e Kosovës ndaj ndryshimeve klimatike dhe mundësive për të vepruar në zhvillimin e një strategjie për ndryshimet klimatike dhe zbatimin e projekteve konkrete në lidhje me të, duke konsideruar zhvillimin e kapaciteteve, përfshirjen e aktorëve, vetëdijen publike dhe mobilizimin e resurseve financiare.

Gjithashtu, në gusht 2009, disa anëtare të MMPH-së dhe Ministrisë së Energjisë e Minierave, janë ftuar të marrin pjesë në një seminar për ndryshimet klimatike në Bon të Gjermanisë, si vëzhgues.

Përderisa bazat ligjore për t'u ballafaquar me mjedisin, edhe pse jo specifiku me ndryshimet klimatike, ekzistojnë tanimë, zbatimi i këtyre ligjeve dhe rregulloreve është i dobët. Kjo mund t'i atribuohet mungesës së burimeve financiare, njerëzore dhe institucionale; të dhënave jo-adekuate mjedisore; vetëdijes së kufizuar në lidhje me ndryshimet klimatike; koordinimit të dobët ndërministror dhe çka është me siguri më e rëndësishmja, mungesës së vullnetit politik për shkak të prioriteteve tjera që kërkojnë vëmendje dhe fonde.

Duke pasur parasysh të mësipërmet, është e qartë që Kosova nuk është akoma seriozisht e përfshirë në çështjen e ndryshimeve klimatike, përkundër seriozitetit të problemit. Është në interesin e Kosovës të fillojë të interesohet më shumë dhe kapitulli në vijim paraqet një qasje të mundshme që përfshin një numër veprimesh që sëbashku do të përbënin një strategji për Kosovën, që të bëjë një hap përpara dhe të luajë një rol serioz në luftimin e ndryshimeve klimatike.

## KAPITULLI 3 NJË QASJE STRATEGJIKE PËR KOSOVËN

---

Pse Kosovës i duhet një strategji?

Siç u theksua më lart, ngrohja globale është e paevitueshme, por ashpërsia e saj mund të kufizohet dhe metodat e arritjes së kësaj janë gjerësisht të ditura. Problemet e Kosovës janë të dukshme dhe zgjidhja e tyre gjithashtu. Në mënyrë që të arrihet ndryshimi, Kosova duhet të prodhojë një strategji afat-gjatë ku identifikohen hapat e nevojshëm për të kapur ndryshimet klimatike sa më larg të jetë e mundur. Natyrisht kjo duhet të marrë parasysh vështirësitë financiare, institucionale dhe ligjore të Kosovës, përfshirë prioritetin e zgjidhjes së kontestit politik me Serbinë, në lidhje me Pavarësinë.

Një numër metodash që shtetet dhe industrinë të reduktojnë emetimet e gazrave janë zhvilluar nga UNFCCC, kryesisht për tregtimin e emetimeve të karbonit, mekanizmat e zhvillimit të pastër dhe përmasat e zbatimit të përbashkët ( për më shumë detaje, shih faqe 4). Megjithatë, është e paqartë nëse Kosova mund të fitojë qasje direkte në ndonjë nga këto programe tani për tani, pasi që nuk është anëtare as e OKB-së as e UNFCCC-së. Ndërkohë, Kosova mund të ketë nevojë për asistencë nga donatorët, në veçanti BE dhe Banka Botërore.

Siç u shpjegua më herët, Kosova duhet të ballafaqohet me tri çështje specifike të ndryshimit klimatik:

Emetimet nga termocentralet e tanishme dhe te planifikuara

Emetimet nga automjetet motorike

Shpyllëzimi

Në ballafaqim me të mësipërmet, strategji lehtësuese mund të përpilohen.

Reduktimi i emetimeve nga termocentralet

Termocentralet ekzistuese dhe të planifikuara të Kosovës përfaqësojnë kontributin e qartë dhe më të madh në ndryshimet klimatike. Megjithatë, prodhimi i energjisë elektrike është gjithashtu mundësia e saj më e rëndësishme të paktën në afatin e shkurtër. Përderisa fosilet gjithmonë do të emetojnë gazra, të ashtuquajtura “teknologji të pastra të thëngjillit” janë zhvilluar dhe mundësojnë reduktime qenësore të emetimeve. Teknologjitë moderne gjithashtu mundësojnë djegie më efikase, që redukton emetimet për njësi të energjisë elektrike.

Një nga zhvillimet më premtuese për reduktim të emetimeve të CO<sub>2</sub> nga termocentralet e ndezura me thëngjill dhe linjit janë metodat e “kapjes dhe depozitimit të karbonit”, gjithashtu të njohura si sekuestrim karboni. Kjo përfshin kapjen e CO<sub>2</sub> pas lirit të tij, kompresimin e tij, dhe transportimin në një zonë të përshtatshme depozitimi, ku ai futet në tokë. Sipas Raportit Strategjik Mjedisor dhe Social të MMPH-së, kjo teknologji, që nuk është ende komercialisht në dispozicion për centrale të mëdha djegieje, ka potencial për reduktim të emetimeve të karbonit me 80%.

Tani për tani, dokumentet tenderuese për termocentralin e ri (Kosova C) nuk janë në dispozicion për publikun. Kështu, nuk është akoma e qartë çka do të bëhet për të kufizuar emisionet e CO<sub>2</sub> nga termocentralet e reja dhe te vjetra, edhe pse thuhet se do të përdoren teknologjitë e reja.

### **3.3 BURIMET ALTERNATIVE TË ENERGJISË**

Edhe pse ato nuk do të jenë në gjendje të zëvendësojnë termocentralet e linjtit, Kosova ka potencial të përdorë resurse të ripërtërishtme të energjisë elektrike, si ajo solare, energjia nga era, biomasa dhe hidroenergja. Planifikimet për mënyrën se si sisteme të ndryshme të energjisë alternative do të mund të zhvilloheshin dhe zgjeroheshin në vitet e ardhshme, do të përfaqësonin një hap të rëndësishëm. Në ngjashmëri me programet në pjesë tjera të botës, investimet dhe stimulimet e qeverive, si uljet e taksave, do të mund të inkurajonin sektorin privat të zhvillojë këto sisteme, në përfitim të ekonomisë dhe mjedisit të Kosovës.

### **3.4 REDUKTIMI I GAZRAVE DHE CO<sub>2</sub> NGA AUTOMJETET MOTORIKE:**

Automjetet në Kosovë mund të bëhen më pak ndotëse. Kjo do duhej të bëhej në një mënyrë sistematike brenda një afati kohorë që e lejon shoqërinë dhe ekonominë e Kosovës të përshtatet. Një hap i parë efektiv do të ishte fillimi i monitorimit të emetimeve të CO<sub>2</sub> nga automjetet. Kjo është implementuar me sukses në shumë shtete, përfshirë shumicën e atyre të BE-së, përmes inspektimeve vjetore. Njerëzit do të inkurajoheshin të ngasin mjete më pak ndotëse përmes një regjimi tatimor me nivele, gjë që do të stimulonte përdorimin e automjeteve me teknologji më të mirë të reduktimit të emetimeve.

### **3.5 LUFTIMI I SHPYLLËZIMIT**

Zgjidhja për problemin e Kosovës me de-pyllumëzimin mund të ishte mjaft e thjeshtë. Në vend të teknologjisë së re, ajo çka nevojitet është diçka politike për të zhvilluar një sistem efikas për menaxhim të pyjeve, fuqizim i politikave ekzistuese për mbrojtje të pyjeve dhe fillim i një programi plotësues. Si pjesë e këtij të fundit, iniciativa e fundit e qeverisë për të mbjellë dy milion pemë duhet të përcillet me një program sistematik të rimbjelljes, çdo vit.

Tutje, Strategjia e Kosovës për ndryshimet klimatike mund të përfshinte gjithashtu reduktimet në përdorimin e drurit për ngrohje dhe gatim, fillimisht në zonat urbane. Sidoqoftë, një kalim i tillë varet në ekzistencën dhe disponueshmërinë e burimeve alternative e të sigurt të energjisë.

### **3.6 ADAPTIMI**

Përderisa zbutja redukton mundësitë për zhvillim të kushteve të pafavorshme, adaptimi përfshin përgatitjen për ato kushte negative/të pafavorshme që ngriten. Pasi që një nivel i ngrohjes globale është i paevitueshëm, të gjitha shoqëritë do duhet të jenë të gatshme

të përballojnë një të ardhme të pasigurtë. Siç u përshkrua në faqe 8, Kosova tanimë ka përjetuar fenomene të motit ekstrem si valë ngrohjeje, thatësira dhe zjarre në pyje, dhe këto ka gjasa vetëm të rriten në frekuencë dhe ashpërsi. Për t'u ballafaquar me këto, Kosovës i duhen strategji dhe masa për t'u adaptuar. Vonesat tani vetëm do të ngrisin nevojën për adaptime më të dhimbshme më vonë, kur problemi të jetë bërë më urgjent.

Fushat më poshtë janë disa komponente të një strategjie adaptive efektive:

**Rrjedha e informative:** Në mënyrë që të merren vendime efektive dhe të bazuara në informata në lidhje me strategjitë adaptive, individët e Kosovës, bizneset, komunitetet dhe qeveritë kanë nevojë për projektme të sakta të ndryshimeve klimatike dhe të ndikimit mjedisor dhe socio-ekonomik të tyre

**Fleksibiliteti:** Adaptimi efektiv kërkon fleksibilitet për t'iu përgjigjur informative të reja dhe rrethanave të ndryshueshme. Menaxhimi i riskut dhe monitorimi lejojnë fleksibilitetin përmes revidimeve të rregullta të strategjive të miratuara dhe rreziqeve në zhvillim.

**Planifikim paraprak:** Shumica e analistëve pajtohen që veprimet e vonuara do të jenë më të kushtueshme sesa veprimi i parashikuar. Për shembull: investimet në infrastrukturë të re që e përballon klimën dhe zhvillimet në sektorin e banimit në Kosovë, do të ishin shumë më të lira se sa rregullimi ose rindërtimi i mëvonshëm.

**Rrjedha:** Rrjedha është integrimi i çështjeve dhe përgjigjeve në lidhje me ndryshimet klimatike në sektorët e bujqësisë, pylltarisë, ujit, energjisë, sektorit ekonomik, social, shëndetësor e mjedisor. Shumë adaptime të ndryshimeve klimatike sinergjike me zhvillime tjera. Për shembull, mbrojtja kundër rreziqeve të ndryshimeve klimatike shpesh mund të fuqizojë elasticitet kundër ndryshimeve klimatike afatgjata.

**Masa konkrete:** Shembuj të masave adaptive përfshijnë politikat e menaxhimit dhe zhvillimit të tokës; sistemet e paralajmërimit të hershëm për valë të ngrohta dhe shira të rënda; ndërtesa dhe infrastrukturë që përballon klimën dhe masa përballuese ndaj thatësisë, për të përmirësuar sigurinë e ujit.

### 3.7 ADRESIMI I VËSHTIRËSIVE INSTITUCIONALE

Vështirësitë e resurseve të limituara njerëzore dhe financiare në Kosovë, do të jenë evidente gati në çdo aspekt të secilës përpjekje për luftim të ndryshimeve klimatike. Çdo qasje do të kërkojë investim për të forcuar institucionet përmes blerjeve të pajisjeve, trajnimit të stafit dhe punësimit të ekspertëve. Dobësia e tanishme e institucioneve qeveritare dhe e ekonomisë së vendit nënkupton që, në afat të shkurtër, Kosova do të jetë kryesisht e mbështetur në organizata donatore, për resurset e nevojshme financiare dhe humane.

### 3.8 PËRGJIGJJA DREJT BE-SË DHE UNFCCC-SË:

Ka një numër veprimesh që Kosova mund të ndërmarrë si pjesë e një qasjeje strategjike, për ta sjellë atë në linjë me BE-në dhe UNFCCC-në. Gjithsesi, Kosova tanimë ka filluar përpjekjet e saj për të sjellë regjimin e saj ligjor e rregullativ në linjë me BE-në, dhe

kështu duhet të bëjë përpjekje të arrijë caqet e BE-së që deri në vitin 2020 të reduktojë emetimet e gazrave dhe konsumin e energjisë me 20% dhe të rrisë përdorimin e energjisë së ripërtërishme me 20% deri në vitin 2020.

Sa i përket përpjekjeve globale për të luftuar ndryshimet klimatike, Kosova duhet të tentojë të mbahet në hap me anëtarët e UNFCCC-së derisa Kosova të jetë në gjendje t'i bashkohet OKB-së dhe UNFCCC-së. Ndërkohë, ajo mund të bëjë shumicën e veprimeve, si të ishte pjesë e procesit të UNFCCC-së, që përfshijnë:

Krijimin e programeve kombëtare dhe rajonale për lehtësim dhe adaptim;

Identifikimin e një viti bazë nga i cili do të maten emetimet e gazrave;

Prodhimi i një raporti “Komunikimi Kombëtar” për progresin e bërë në implementim të programeve, të miratuara nga UNFCCC;

Integrimi i politikave të ndryshimeve klimatike në planet për zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës;

Promovimi dhe bashkëpunimi në transferim të teknologjitë miqësore ndaj mjedisit;

Promovimi i hulumtimeve, shkëmbimi i informacioneve, edukimi dhe ndërtimi i kapaciteteve;

Krijimi i një inventari nacional të gazrave;

Prodhimi i skenarëve të ndryshimeve klimatike për sektorët shoqërorë, ekonomik dhe mjedisorë.

Duke implementuar plane të tilla, Kosova do të mund të demonstronte seriozitetin e saj drejt ndryshimeve klimatike dhe do të sigurote që është në linjë me pjesën tjetër të botës. Përsëri, kjo do të kërkojë vullnet politik dhe përkushtim serioz resurcesh.

Me siguri më e rëndësishmja është, sidoqoftë, nëse Kosova vepron në çështjen e ndryshimeve klimatike, kjo do të demonstrojë pjesën tjetër të botës që Kosova është një aktore e përgjegjshme ndër popujt e botës. Gjithashtu, përderisa Kosova mund të jetë shtet i vogël në territor dhe popullsi, ajo duhet të paraqesë pranueshmëri për përgjegjësitë e përbashkëta dhe të përfshihet në çështjen e ndryshimeve klimatike, njëllonj siç do të ndante edhe pasojat e dështimit global në këtë çështje.

## **BURIMET:**

Individët e konsultuar

**Hysen Abazi** -Drejtor i Departamentit të Pylltarisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**Fatos Aliu** -Shef i Divizionit të Sistemeve të Energjisë dhe Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Minierave

**Baton Begolli** -Këshilltar i Politikave Ujore, Zyra e Qeverisë

**Agron Bektashi**-Koordinator nacional i projektit, Projekti i pikave të nxehta mjedisore (UNDP)

**Michael L. Boyd** -Këshilltar i Lartë për Energji, Zyra për Zhvillim Ekonomik, (USAID)

**Edon Cana** -Shef Ekzekutiv, Agjencia për Koordinim të Zhvillimit dhe Integrim në BE

**Shkipe Deda**-Menaxhere vendore e projektit, “Milieu Kontakt International Kosovo”

**Ardian Gjini** -Kryetar i grupit parlamentar të Partisë në opozitë në Kosovë

**Lorik Haxhiu** -Menaxher zyrës së Projektit, Termocentrali Kosova C (World Bank)

**Lulzim Korenica**-Shef i Sektorit të Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Minierave

**Naser Krasniqi**-Koordinator Nacional, FAO

**Deme Lokhaj**-Drejtor i Menaxhimit të Pyjeve

**Muhamet Malsiu**-Drejtor i Departamentit të Mjedisit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

**Kazuki Matsuura** -Analist i Programit , UNDP Kosovë

**Lisa Mattisson** -Specialiste e Programit të Mjedisit , UNDP Kosovë

**Hilmi Morina** -Drejtor, Departamenti i Energjisë, Ministria e Energjisë dhe Minierave

**Illir Morina** -Shef i Agjencisë Kosovare për Mjedis

**Arben Nagavci** -USAID Kosovo

**Luan Shllaku**-Kryetar i Fondacionit Kosovar për Shoqëri të hapur

**Iva Stamenova** -Zyra Ndërlidhëse, Resurse Natyrore dhe Mjedis, Komisioni Evropian në Kosovë

**Zeqir Veselaj** -Drejtor i zyrës së REC në teren

**Edon Vrenezi** -Zyrtar i operimeve, Zhvillim i qëndrueshëm, Energji, Mjedis, Transport (Banka Botërore Kosovë)

## **BIBLIOGRAFIA:**

Bekteshi, F. (2008) “Sfidat e Kosovës,” Prishtina, REC

Climate Change Fact Sheet:  
<http://www.thegreatwarming.com/pdf/ClimateChangeFactSheet.pdf>

Komisioni i Komuniteteve Evropiane (2009) “Drejt një Marrëveshjeje Gjithëpërfshirëse për Ndryshimet Klimatike në Kopenhagë”

Kushtetuta e Republikës së Kosovës,  
<http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>

EIRIS (2009) “Kompasi i Ndryshimeve Klimatike: rruga për Kopenhagë”,  
[www.eiris.org](http://www.eiris.org)

ERT (2009) “Energjia dhe Ndryshimet Klimatike: Sigurimi i të ardhmes së Evropës, Mirëmbajtja e Konkurrencës dhe Luftimi i Ndryshimeve klimatike ”

EUROPA (2005) “ Dosja e fakteve për Mjedisin: Ndryshimet Klimatike,”  
[http://ec.europa.eu/environment/climat/pdf/cc\\_factsheet\\_aug2005.pdf](http://ec.europa.eu/environment/climat/pdf/cc_factsheet_aug2005.pdf)

Agjencia Evropiane për Rindërtim, Ministria e Energjisë dhe Minierave (2008) “Lot No. 4 Studimi i Resurseve të Energjisë së Ripërtërishme në Kosovë,” Raporti i Draftit përfundimtar

Komisioni Evropian (2002) “Programi Veprues i gjashtë i Komunitetit të Mjedisit”

Komisioni Evropian (2006) “Veprimet e BE-së kundër Ndryshimeve Klimatike: Reduktimi i emetimeve nga Sektorët e Energjisë dhe Transportit”.

Komisioni Evropian (2006) “Reduktimi i emetimeve nga Sektorët e Energjisë dhe Transportit: Veprimet e BE-së kundër Ndryshimeve Klimatike”

Komisioni Evropian, (2007) “Luftimi i Ndryshimeve Klimatike, BE udhëheq rrugën,”  
[www.ec.europa.eu/publications](http://www.ec.europa.eu/publications)

FAO (2002-03) Inventari i Pylltarisë

Qeveria e Kosovës (2004) “Strategjia Mjedisore dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm për Kosovë”, Draft

Rrjeti Ndërkombëtar i Politikave, (2004) “Ndryshimet klimatike dhe zhvillimi i qëndrueshëm: një mostër nga Rrjeti Ndërkombëtar i Politikave.”

KEPA & Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2008) Raporti Gjendja e Mjedisit 2006-2007, Prishtinë, KEPA

Protokolli i Kjetos <http://unfccc.int/resources/docs/convkp/kpeng.pdf>

Ligji Nr. 03/L-025: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009\\_03-L-025\\_en.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2009_03-L-025_en.pdf)

Ligji Nr. 03/3: Ligji për Pyjet [http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=244&Itemid=28](http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=244&Itemid=28)

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2006) Plani i Veprimit i Kosovës për Mjedisin 2006-2010, Prishtinë

O'Neill, B. & Oppenheimer, M. (2002) "Ndikimet e rrezikshme të klimës dhe Protokollit i Kjotos", Shkencë, Vëll. 296

Shllaku, L. et al (2007) Forum 2015: "Një përrallë moderne: Energjia nga Linjiti në Kosovë: Kufizimet e Qëndrueshmërisë"

Solomon, S. et al (eds.) (2007) "Ndryshimet klimatike 2007: Baza e Shkencës Fizike," Raporti i 4-t i vlerësimit i IPCC

Programi i gjashtë i veprimit i Komunitetit Evropian 2002-2012.

Të mendojmë gjelbër (qershor 2, 2009), Letra e politikave, [www.iksëeb.org](http://www.iksëeb.org)

UNDP (2007) "Energjia për Zhvillim: Raporti i Zhvillimeve Humane në Kosovë"

UNDP "ndryshimet klimatike në UNDP, ngritja për të përballuar sfidën, Grupi i UNDP-së për Mjedis dhe Energji"

UNDP (2009) Punëtori për Mjedisin, Konferenca e Ndryshimeve Klimatike, prill 28-29 2009, [http://www.ks.undp.org/repository/docs/UNDP\\_ëorkshop\\_EV.pdf](http://www.ks.undp.org/repository/docs/UNDP_ëorkshop_EV.pdf)

UNDP (2009) Konferenca Mjedisore, Konferenca për Ndryshimet Klimatike, prill 28-29, 2009, [http://www.ks.undp.org/repository/docs/UNDP\\_conference\\_EV.pdf](http://www.ks.undp.org/repository/docs/UNDP_conference_EV.pdf)

UNFCCC (2009) "Veprimet ndërkombëtare për ndryshimet klimatike: rruga për Kopenhagë."

Banka Botërore (2007) "Integrimi i Mjedisit në Bujqësi dhe Pylltari, Progresi dhe Prospektet në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore", vëllimi II

Wijen, F. & Zoetemann, K. (2004) "E kaluara dhe e ardhmja e Protokollit të Kjotos," Instituti për Globalizim dhe Zhvillim të Qëndrueshëm

Prezantimet në konferencën për Ndryshime klimatike

Anna Kaplina, "Ndryshimet klimatike si Sfidë e Zhvillimit Njëëzor "

"Ndryshimet Klimatike tek UNDP: ngritja për t'u përballur me sfidën "

Teodora O. Grncarovska "Çështjet e Ndryshimeve Klimatike dhe Republika e Maqedonisë" (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik)

Shpresa Mezini “Përvoja e vendit në kornizën e Komunikimeve Kombëtare për UNFCCC ” (Ministria e Mjedisit, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave, Shqipëri)

Maria Khovanskaya “Përvojat e çështjeve të Ndryshimeve Klimatike në Evropën Juglindore” (REC UNDP)

Daniela Stoycheva “Qeverisja Globale e Ndryshimeve Klimatike – UNFCCC dhe Protokollin e Kjosës” (UNDP)

Andrew Karam & Ronald Meyers “Kontributet individuale në përballje me sfidat e ndryshimeve klimatike” (Universiteti Amerikan në Kosovë)

Lučka Kajfež Bogataj “Gjetjet kyçe nga Raporti i katërt i vlerësimit të IPCC” (WG2 ish zv.kryesues, IPCC Universiteti i Lubjanës, Slloveni)

Ute Rodrian “Roli i KfW’së në çështjet e Ndryshimeve Klimatike,” (Zyra Rajonale, Tiranë, Prishtinë, Shkup)

Nebojša Jablan “Mali i Zi: Një paraqitje e shkurtër e ndryshimeve klimatike dhe statusi energjetik, projektet rajonale/tej-kufitare, raportime ”

Ilir Morina “Gjendja e Mjedisit në Kosovë dhe Ndryshimet klimatike ”

Faqet e internetit

<http://unfccc.int/> Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

<http://www.ks-gov.net/mem/> Ministria e Energjisë dhe Minierave

[http://www.ks-gov.net/mmph/english/index\\_eng.htm](http://www.ks-gov.net/mmph/english/index_eng.htm) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

<http://www.mbpzhr-ks.org/indexeng.php> Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

<http://www.rec.org/> Qendra Mjedisore Rajonale për Evropën Qendrore dhe Lindore


[www.policynetwork.net](http://www.policynetwork.net)

Rrjeti

i

Politikave

## SHTOJCA 1 EFEKTI SERRË



Burimi:

<http://www.global-greenhouse-warming.com/images/GreenhouseEffectDiagram.jpg>

## SHTOJCA 2 MOMENTET HISTORIKE TE NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

1979	<p>Konferenca e parë Botërore për Klimën - Klima si resurs vital natyror</p> <p>-Jeto në harmoni me natyrën - Qeveritë duhet të 'parashikojnë dhe të parandalojnë ndryshimet klimatike të prodhuara nga njeriu, që mund të jenë të dëmshme për mirëqenien e njerëzimit'</p>
1987	<p>Raporti i Komisionit të Brundtland</p> <p>- Nevoja për të adoptuar një rrugë të qëndrueshme zhvillimi, që do të ndihmonte në arritjen e nevojave të tanishme, përderisa lë mjaft resurse për t'u ballafaquar me nevojat e së ardhmes.</p> <p>Precedenti i vendosur nga negociatat e suksesshme të Protokollit të Montrealit</p>
1988	<p>Organizata Botërore e Meteorologjisë dhe Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara themeluan IPCC (Panelin Ndërqeveritar për Ndryshime Klimatike)</p>
1989	<p>Rezoluta e Kuvendit të Përgjithshëm të OKB-së thërret samitin global për çështje zhvillimore dhe mjedisore</p>
1990	<p>Publikohet Raporti i parë i Vlerësimit të IPCC-së Rezoluta e Kuvendit të Përgjithshëm të OKB-së themelon INC-në ( Komitetin Negociues Ndërqeveritar) për të përpiluar një kornizë-konventë</p>
Shkurt 1991 deri maj 1992	<p>Përfaqësues të 160 kombeve negociojnë çështje kyçe</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përkushtimet për caqet e emetimeve</li><li>- Përmasat për Transferet teknologjike dhe resurset financiare për shtetet në zhvillim</li></ul>
Maj 1992	<p>INC miraton UNFCCC (Konventën e Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike)</p>
Qershor 1992	<p>UNFCCC u hap për nënshkrime në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Mjedis (Samiti i Tokës në Rio)</p>
21 mars 1994	<p>UNFCCC hyn në fuqi me 21 mars 1994 (ratifikuar nga 186 shtete deri në korrik 2002)</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pa caqe me detyrime ligjore (Aneksi I, shtetet u kthehen niveleve të vitit 1990 deri në fund të dekadës)</li><li>- Dërgimi i Komunikimeve Nacionale</li></ul>

Prill 1995	<p>Konferenca e parë e palëve (COP-1) në Berlin, miraton Mandatin e Berlinit. Një raund i ri i negociatave u iniciua në një “protokoll ose instrument tjetër ligjor”</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pa përkushtime të reja për shtetet që nuk janë në Aneks I</li> <li>- Paraqitje e parë e Aktiviteteve të Bashkë-Implementuara (AIJ) – Projekte vullnetare kooperative për zbutje të gazrave</li> </ul>
Dhjetor 1995	<p>IPCC aprovon raportin e saj të dytë të vlerësimit. Konkluzat e tij nënvizojnë nevojën për veprim të fuqishëm politik.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bilanci i evidencës sugjeron një ndikim të dukshëm njerëzor për klimën globale</li> <li>- Mundësi qenësore “pa kthim prapa” vihen në dispozicion</li> <li>- Rrezik potencial dëmtues i mjaftueshëm për të arsyetuar veprimet tutje atyre “pa kthim prapa”</li> </ul>
Korrik 1996	<p>COP-2 në Gjenevë shënon Deklaratën Ministrore të Gjenevës, që vepron si një nxitës vazhdimësie në negociata</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hulumtimet shkencore japin bazë për veprime urgjente fuqizuese</li> <li>- Bota përballet me ndikime qenësore, shpesh negative nga ndryshimet klimatike</li> <li>- Reduktime të përgjithshme të gazrave, të obligueshme ligjërisht do të negociohen në Konferencën e ardhshme të Palëve (COP)</li> </ul>
Dhjetor 1997	<p>Takimi i tretë i palëve - COP-3 në Kjoto miraton protokollin e Kjosos nën Konventën Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike</p>
Mars 1998	<p>Protokolli i Kjosos hapet për nënshkrim në selinë qendrore të OKB-së në Nju Jork. Për një periudhë një vjeçare, ai merr 84 nënshkrime</p>
Nëntor 1998	<p>Takimi i katërt i Palëve - COP-4 në Buenos Aires miraton Planin e Veprimit të Buenos Airesit, që paraqet një program pune në detajet operative të Protokollit të Kjosos dhe implementimin e Konventës. COP-6 u vendos si afat i fundit për miratim të shumë vendimeve të rëndësishme.</p>
Nëntor 1999	<p>COP-5 në Bon paraqet një kornizë kohore agresive për të arritur progres të matshëm deri në COP-6 kur hyn në fuqi Protokollin i Kjosos</p>
Nëntor 2000	<p>COP-6 takohen në Hagë, por dështojnë të pajtohen për një pako vendimesh nën Planin e Veprimit të Buenos Airesit</p>

---

Korrik 2001	COP-6 pjesa II (ose COP-6b) ritakohet në Bon. Palët miratojnë marrëveshjet e Bonit, duke regjistruar konsensus politik për çështjet kyçe nën Planin e Veprimit të Buenos Airesit. Ata gjithashtu kompletuan punën në një seri vendimesh të detajuara, por disa mbeten akoma të famshme.
Tetor/nëntor 2001	COP-7 në Marrakesh finalizon dhe formalisht miraton vendimet e COP-6b si Pajtimet e Marrakeshit
Tetor/nëntor 2002	COP-8 do të mbahej në Nju Delhi

---

Burimi : [http://www.envfor.nic.in/cc/int\\_nego/timeline.htm](http://www.envfor.nic.in/cc/int_nego/timeline.htm)

## **SHTOJCA 3 POLITIKAT RAJONALE**

### **SHQIPËRIA**

Shqipëria dorëzoi komunikimin e saj të dytë nacional tek UNFCCC në Nëntor të vitit 2009. Një “strategji financuese e karbonit” është në proces të zhvillimit bashkë me Strategjinë e Komunikimit të Ndryshimit Klimatik. Ajo ka ndërmarrë më tej disa projekte në lidhje me financimin e karbonit, ngrohjes solare të ujit, adaptim ndaj ndryshimit klimatik, zhvillim të mekanizmave të pastra (CDM) dhe krijim të territoreve karbon neutrale.

### **MAQEDONIA**

Maqedonia ka dërguar dy komunikime nacionale tek UNFCCC, e fundit dërguar në Dhjetor 2008. Një vit më herët, Maqedonia përpiloi një strategji kombëtare për CDM (2008-2012) dhe një strategji nacionale për miratimin e Acquis Communautaire për Mjedis. Maqedonia gjithashtu ka miratuar edhe Strategjinë Kombëtare për Investime Mjedisore, e cila thekson potencialin e financimit të karbonit për tërheqje të investimeve të huaja.

Nën ligjin e saj për mjedis, Maqedonia ka këto tri fokuse:

*Përgatitjen e një inventari për emetimet e gazrave dhe largimeve me gropa*

*Zhvillimin e një plani për zbutje dhe adaptim të ndryshimeve klimatike*

*Zhvillimin e mekanizmave të pastra*

Në nivel institucional, Maqedonia ka një koordinator për ndryshime klimatike Brenda Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Fizik. Gjithashtu është caktuar një autoritet kombëtar për t'u marrë me aktivitetet në lidhje me CDM.

Maqedonia ka nënshkruar memorandume bilaterale të mirëkuptimit në lidhje me financimin e karbonit me qeverinë italiane dhe atë sllovene si dhe me UNDP-në.

### **MALI I ZI**

Mali i Zi ka ratifikuar Protokollin e Kjosës në vitin 2007. Si rezultat, ky shtet ka për qëllim të dërgojë komunikimin e parë nacional tek UNFCCC në vitin 2010. Një draft inventar nacional i gazrave për vitin 1990 (si vit bazë), 1998 dhe 2003 është krijuar.

Në vitin 2007, Qeveria e Malit të Zi ka hartuar një Strategji kombëtare për Zhvillim të Qëndrueshëm, e cila ka për qëllim integrimin e përgjigjeve ndaj ndryshimeve klimatike

në politika sektoriale. Shteti po bën përputhjen e legjislacionit të tij me standardet e BE-së për ndryshime klimatike dhe energji.

Dokumenti shtesë dhe legjislacioni i hartuar në Maqedoni përfshinë:

Politika energjetike dhe Strategjia për Eficiencë të Energjisë, 2005

Strategjia për Zhvillimin e Hidrocentraleve të Vogla, 2006

Traktati i Komunitetit të Energjisë, ratifikuar në tetor 2006

Studimi për Vlerësimin e Potencialit të Ripërtërishëm – Energjia nga era, energjia solare dhe biomasa (2007)

Strategjia për Zhvillimin e Energjisë, deri 2025, 2007

Themloi Autoriteti përgjegjës kombëtar për projektet CDM (shkurt 2008) si model I ministrisë së vetme (brenda Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit )

Themloi Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me departamentin për ndryshimet klimatike (nëntor 2008)

Identifikoi projekte CDM në mbetje solide komunale, energji të ripërtërishme, efikasitet të energjisë dhe sekuestrim të karbonit (2007)

Lëshoi Thirrjen për Shprehje të Interesit për bashkëfinansim në përgatitjen e studimeve të fizibilitetit për identifikim të projekteve potenciale për reduktim të emetimeve, nën CDM (Mars 2008)

Shprehu dëshirën për të arritur objektivat e Strategjisë së BE-së për Energji dhe Klimë

## **SERBIA**

Serbia ka ratifikuar Protokollin e Kjosos në vitin 2007, me hyrje në fuqi në vitin 2008. Si rezultati kësaj, Serbia ende nuk ka dërguar komunikimin e parë nacional tek UNFCCC. Serbia gjithashtu akoma nuk ka një strategji nacionale për klimën, që është projektuar për vitin 2011. Në vitin 2008, një strategji kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm është miratuar, e cila përmban referenca për ndryshimet klimatike.

Duhet të shënohet që informata buxhetore për iniciativa në lidhje me ndryshimet klimatike, për shtetet e rajonit, nuk kanë mundur të jenë në dispozicion, përkundër përpjekjeve për t'i marrë ato nga burimet qeveritare.

